



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 309, Datë 30.11.2022

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “BIGWIND” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE QARKU FIER**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1999/5 prot., datë 24.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 277, datë 27.10.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2022 dhe 29.10.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 03.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar

pjesërisht. Në vijim shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815/2 prot., datë 14.11.2022, duke depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- ERE i është drejtuar shoqërisë sërish me shkresën nr. 1815/3 prot., datë 18.11.2022, për plotësimin e një pjese të dokumentacionit të paplotësuar. Në përgjigje, shoqëria ka përcjellë dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815/4 prot., datë 18.11.2022 dhe ka depozituar dokumentacion plotësues.
- Nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria, rezulton se ka ndryshuar mënyra e financimit të projektit, referuar parashikimeve të vetë shoqërisë në planin e biznesit, ndaj shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi mbështetjen financiare.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rasti pas rasti, dhe konkretisht:
3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Sa më sipër vlerësohet të zgjatet me 20 (njëzetë) ditë vendimmarrja e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës që vërteton mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaiik, referuar parashikimeve të planit të biznesit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 20 ditë vendimmarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje Qarku Fier.
2. Brenda 10 ditëve, shoqëria “BIGWIND” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaiik, referuar parashikimeve të planit të biznesit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI